

**VEPRIMTARIA**

Krijohet Këshilli Lokal i Paqes në Bashkinë Kamëz



FAQE 6

**INVESTIME**

Mes projekteve të realizuara nga Bashkia, ndërtimi i kanalizimeve në rrugën "Viktor Hygo"



FAQE 3

**PROJEKTI I UJËSJELLËSIT**

Takim i kryebashkiakut Mziu me konsulentin Jaap Boomsma për rezultatet e arritura



FAQE 4

**SOCIALE**

Në Bashkinë Kamëz u organizua takim për parandalimin e dhunës ndaj të miturve



FAQE 7



Gazetë e Bashkisë Kamëz

# KAMZA

E përdyjavshme  
Nr. 216 korrik 2018  
Çmimi 20 lekë  
drmediakamez@gmail.com  
www.kamza.gov.al

**Po bëhet pedonalja, qendra e qytetit, dhjetëra rrugë dhe KUN**

## KAMZA - KANTIER NDËRTIMI

FAQE 2

**Bashkia Kamëz, e gatshme që të investojë në çdo rrugë dhe çdo lagje**

Faqe 3

**Nëpunësit e Rajonit Bathore, korrektësi në zbatimin e detyrave të lëna**

Faqe 4

**Të dhënat pozitive për 6-mujorin, tregues premtues për realizimin e objektivave nga ana e Bashkisë Kamëz**

Faqe 5

**Trajnim nga Bashkia Kamëz në bashkëpunim me "World Vision" në kuadrin e projektit të mbrojtjes së fëmijëve**

Faqe 8



**Vizitë pune e kryebashkiakut Xhelal Mziu në Komunën Castenaso në Itali, qytet i binjakëzuar me Kamzën, me ftesë të kolegut Stefano Sermenghi**

FAQE 6



**NË BRENDESI**

Kryebashkiaku Mziu, i pranishëm në promovimin e librit kushtuar Gani Cahanit të autorit Esat Bytyçi

FAQE 8

Kamza e 6-ta për popullsinë në vend, por Bashkia me më pak familje të trajtuar me ndihmë ekonomike

FAQE 7

Ndërtimi i rrugës "Asdreni" në Bathore 4, tjetër investim shumë i rëndësishëm i Bashkisë Kamëz me fondet e veta

FAQE 2

Njësia Administrative e Paskuqanit, e angazhuar për të realizuar objektivat

FAQE 4

Brenda një muaji, veprimtari të shumta në Pallatin e Kulturës Kamëz

FAQE 8





## Kamza - kantiere ndërtimi, po bëhet pedonalja, qendra e qytetit, dhjetëra rrugë dhe KUN

Në Kamëz punohet çdo ditë dhe madje me intensitet. Zona është kthyer e gjitha në një kantiere ndërtimi, ku firmat e kontraktuara nga Bashkia janë në terren për kryerjen e investimeve të planifikuara për vitin 2018, por edhe në përfundimin e atyre investimeve, të cilat ende nuk janë përfunduar për arsye objektive. Kryebashkiaku Xhelal Mziu është thujse çdo ditë në inspektive për të parë punën e krye në terren dhe duke nxitur firmat dhe administratën të jenë aktive në realizimin në kohë të punimeve dhe me cilësi. Investimet e Bashkisë Kamëz në infrastrukturë ia kanë ndryshuar fytyrën qytetit, zonave të tjera në Kamëz, si në Bathore, Valias, Laknas, Frutikuturë, pa harruar as investimet imediate që ka Paskuqani i lënë në harresë para bashkimit me Kamzën, por investimet këtë mandat kanë qenë prioritet absolut i Bashkisë Kamëz, duke përmirësuar dukshëm infrastrukturën. Veç investimeve madhore, si aksi i rrugës nga Ura e Institutit tek Kafja e Rremës, rreth



7 km, rehabilitimi i qendrës së Babrrusë, është punuar edhe në mjaft KUN dhe akse rrugore të brendshme. E njëjta gjë edhe në Kamëz, ku ndërtimi i rrugëve dhe KUN ka qenë prioritet absolut i Bashkisë, teksa aktualisht po realizon një prej investimeve më madhore në qytet me fondet e veta, për faktin se qeveria nuk ka dhënë asnjë qindarkë si në qytetet e tjera, si: pedonalja dhe qendra e re e qytetit Kamëz. Duket theksuar fakti se Bashkia Kamëz ka mundur t'ia dalë që, me të ardhurat e veta, falë një miradministritimi korrekt, të mund të kryejë investime të rëndësishme në funksion të komunitetit



dhe duke përmirësuar ndjeshëm jetesën e tyre.

Qeveria "Rama" e ka diskriminuar këtë zonë, duke e parë politikisht, duke mos i financuar investime, megjithëse se mbi 137 projekte flenë në sirtarët e qeverisë. Pavarësisht se vitin e kaluar dhe më përpara Bashkia Kamëz ka kryer me dhjetëra e qindra investime, edhe për vitin 2018 po kryen dhe janë në proces prokurimi për të nisur punimet dhjetëra e dhjetëra investime në Kamëz, Bathore dhe Paskuqan. Më konkretisht, në Kamëz janë kryer dhe po kryhen investimet në KUN, si: rruga "Berlin", rruga "Bernë",

"Burimi", "Çorovodë", "Deçani", "Hasi", "Idriz Seferi", "Lezha", Qendër-Laknas afër varrezave, KUN te rruga "Nazmi Rushiti", "Prezë", "Shkëndija", "Kongresi i Lushnjës", "Kujtesa", "Orikumi", të mbaruara këtë vit; investime në rrugët "Konispoli" dhe "Zef Lleshi", "Montekarlo", "7 Marsi", "Arraz"- "Abaz"- "Horizont", "Bajram Curri", "Bërzhitë", "Bujar Lako" (trotuar), "Bytyçi", "Drini", Rruga e Zanave, "Eqrem Çabej", "Fan Noli", rruga "Iliria", "Kosova", "Kuvendi i Dibrës", "Leskoviku", "Londër" (vazhdim), "Lura", "Macukull", "Mbretëresha Suzanë", zgjerimi i rrugës "Monarkia Shqiptare", "Pjetër Arbnori", "Prizreni", "Roma", "Thethi", "Tiranë"- "Berati" si dhe fusha e sportit në Laknas, "Tomori", "Zadrira", rruga "Zhvillimi" në Valias.

Në Paskuqan po kryhen punimet në KUN pranë shkollës "Tahir Sinani", në rrugët "Dino Kalenja", "Ibrahim Rugova", "Isuf Xhelili", "Petro Nini Luarasi", "Prengaj", "Azem Galica", "Abaz Ermenji", "Abaz Shehu", "Ali Këlcyra".

### Vijojnë punimet për ndërtimin e kanalizimeve në rrugën "Orikumi"



Vijojnë punimet për ndërtimin e kanalizimeve në rrugën "Orikumi", një investim i rëndësishëm i Bashkisë Kamëz në Laknas. Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të ndotura në këtë rrugë bën pjesë në projektet e Bashkisë Kamëz për vitin 2018. Segmenti ku do të ndërhyhet me këtë investim të nevojshëm për banorët e zonës, është i gjatë 200 metra linearë, ku po përdoren tuba Ø 600 mm. Investimi u shërben banorëve të zonës, si dhe bizneseve të ndryshme. Me realizimin e këtij projekti, shkohet edhe një hap më tej drejt objektivit për të arritur standarde bashkëkohore të infrastrukturës në të gjitha hapësirat e qytetit, qendër dhe jo qendër. Investimi realizohet me fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2018 të Bashkisë. Me përfundimin e tij zgjidhet problemi i kanalizimeve në këtë zonë. Bashkia Kamëz ka të gatshme me dhjetëra projekte, të cilat kanë të bëjnë me nevojat parësore të qytetarëve, siç është ndërtimi i rrugëve, ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura, ndërtimi i shkollave dhe i kopshteve, i qendrave shëndetësore etj.

### Investimet e Bashkisë Kamëz në Laknas, mes tyre edhe rrjeti i kanalizimeve në rrugën "Muharrem Bajraktari"

Ndër investimet e Bashkisë Kamëz në lagjen e Laknasit është edhe rrjeti i kanalizimeve në rrugën "Muharrem Bajraktari". Bashkia, me fondet e veta, ka realizuar mes dhjetëra projektsh, e ndërtimit të KUN-së në rrugën "Muharrem Bajraktari" në lagjen Laknas. Ky segment KUN-je është një rrjet shumë i domosdoshëm për banorët e kësaj rrugë, që shërben për të lidhur një pjesë të lagjes së Laknasit që kufizohet me ish-komunën e Domjes. Është bërë një linjë tubacioni me D=600 dhe intersektime me D=400, duke u shoqëruar me puseta 1x1x1.5. Ky segment KUN-je ku ka investuar Bashkia është i gjatë 452 metra linearë. Me ndërtimin e rrjetit të KUN-së, një nga shqetësimet më të mëdha të këtyre banorëve merr zgjidhje. Bashkia ka të gatshme me dhjetëra projekte, të cilat kanë të bëjnë me nevojat parësore të komunitetit, siç është ndërtimi i rrugëve, ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura, ndërtimi i shkollave dhe i kopshteve, i qendrave shëndetësore etj.



### Ndërtimi i kanalizimeve në rrugën "Selenicë", lagja nr. 5 Bathore



Mes investimeve të realizuara të Bashkisë Kamëz në këto dy vite është edhe ndërtimi i kanalizimeve në rrugën "Selenicë", lagja nr. 5 Bathore.

Në këtë lagje është ndërtuar rrjeti i kanalizimeve të ujërave të ndotura që është një tjetër investim që i shtohet kësaj zone.

Segmenti ku është ndërtuar rrjeti i KUN-së ka një gjatësi prej 850 ml.

Me fondet e parashikuara në buxhetin e saj, Bashkia Kamëz ka realizuar edhe këtë projekt jetik për banorët, pasi me përfundimin e tij është zgjidhur problemi i kanalizimeve. Ky investim i Bashkisë Kamëz ka lehtësuar shkarkimin e ujërave të ndotura të zonës, duke pasur parametra bashkëkohorë, që i përshatën zhvillimit të zonës. Për të gjithë segmentin, janë përdorur tuba me përmasa Ø 400, Ø 500; si dhe mbushje e plotë e kanalit të KUN-së me zhavorr.

### Ndërtimi i KUN në rrugën "Uilliam Shekspir", mes dhjetëra investimeve në Frutikuturë të realizuara nga Bashkia



Ndërtimi i kanalizimeve në rrugën "Uilliam Shekspir" bën pjesë te dhjetëra investime në lagjen Frutikuturë të realizuara nga Bashkia Kamëz. Edhe pse për syrin e shumëkujt mund të mos jenë të dukshme, ndryshe nga asfaltimi i rrugëve, kanalizimet e ujërave të ndotura (KUN) përbëjnë një investim të dobishëm për banorët e zonës. Projekti është realizuar nga Bashkia Kamëz, duke qenë kështu një përgjigje për kërkesat dhe shqetësimet e qytetarëve. Ndërkaq, Bashkia garanton të gjithë qytetarët, në të gjitha lagjet, se investimet do të përfshijnë çdo zonë, kjo duke u nisur nga prioritetet dhe nevojat më emergjente të komunitetit, për shkak të mosfinancimit të projekteve të Bashkisë nga ana e qeverisë aktuale. Kështu, edhe KUN në rrugën "Uilliam Shekspir", me gjatësi 210 metra linearë, ku janë përdorur tuba me përmasa Ø 300 mm, është financuar tërësisht nga buxheti i Bashkisë, me qëllimin për të qenë sa më pranë qytetarëve të saj me investime në infrastrukturën rrugore dhe atë të ujësjellës-kanalizimeve.

### Ndërtimi i rrugës "Asdreni" në Bathore 4, tjetër investim shumë i rëndësishëm i Bashkisë Kamëz me fondet e veta



Bashkia Kamëz me fondet e veta do të investojë për ndërtimin e rrugës "Asdreni". Ndërtimi i kësaj rrugë në lagjen 4 në Bathore është një tjetër investim shumë i rëndësishëm nga Bashkia për banorët e kësaj zone. Kjo rrugë është me gjatësi 304 ml dhe do të ndërtohet me të gjithë parametrat e nevojshëm. Rruga "Asdreni" në Bathore do të ketë impakt të jashtëzakonshëm, pasi do t'u shërbejë jo vetëm banorëve të kësaj lagjeje, por edhe banorëve të lagjeve të tjera, pasi lidhë rrugën "Demokracia" me rrugën "Arbrit". Gjithashtu, do të ndikojë edhe në zhvillimin e biznesit të këta banorë. Ky investim shumë i rëndësishëm në këtë zonë bënë pjesë në radhën e dhjetëra investimeve të Bashkisë me ndikim të madh social për komunitetin. Ndërtimi i kësaj rrugë është shumë i domosdoshëm, pasi momentalisht është në kushte jo të përshatshme për të kaluar jo vetëm për banorët e kësaj lagjeje, por edhe me gjerë.



# Bashkia Kamëz, e gatshme që të investojë në çdo rrugë dhe çdo lagje

Korrik 2018  
GAZETA KAMZA

3



## Shembull konkret është projekti i realizuar për ndërtimin e kanalizimeve në rrugën "Hasi" në Valias

Bashkia Kamëz është e gatshme që të investojë në çdo rrugë dhe çdo lagje. Një shembull konkret është projekti i realizuar për ndërtimin e kanalizimeve në rrugën "Hasi" në Valias. Rrjeti i kanalizimeve në rrugën "Hasi", Valias, me gjatësi 950 metra linearë, përbën një investim me impakt të jashtëzakonshëm për banorët e zonës.

Ky projekt është financuar nga buxheti i Bashkisë Kamëz. Në KUN e rrugës "Hasi" janë përdorur tuba me përmasa Ø 600 mm, Ø 500 mm dhe Ø 315 mm. Ky investim i rëndësishëm është realizuar për shkak të problematikave që shkaktonte te banorët e asaj zone mungesa e tij. Në bazë të kërkesave të tyre



nga Bashkia Kamëz u pa e nevojshme të ndërtohej rrjeti i KUN-së në rrugën "Hasi", duke realizuar kështu projekt të rëndësishëm në drejtim të ofrimit të një infrastrukture të dobishme dhe bashkëkohore për qytetarët. Ashtu si realizimi i projektit për ndërtimin e KUN në rrugën "Hasi" të Valiasit, Bashkia Kamëz është e angazhuar të investojë në gjithë territorin e saj, duke përfshirë çdo zonë. Edhe pse vijon diskriminimi i qeverisë, e cila nuk financon asnjë projekt për Kamzën, është Bashkia e cila mbetet e vendosur për të ofruar investime dhe shërbime korrekte për qytetarët e vet.

## Mes projekteve të realizuara nga Bashkia, ndërtimi i kanalizimeve në rrugën "Viktor Hygo"



Mes projekteve të realizuara nga Bashkia është edhe ndërtimi i kanalizimeve në rrugën "Viktor Hygo" në lagjen Frutikulturë. Ky investim i Bashkisë Kamëz është mjaft i dobishëm, pasi përmirëson kushtet e jetesës së banorëve të zonës. Megjithatë ka një gjatësi prej 210 ml, zbatim i projektit ndikon pozitivisht te një numër i madh familjesh, pasi përbën një investim të rëndësishëm në kuadrin e ofrimit të shërbimeve sa më cilësore për qytetarët. Në këtë rrjet kanalizimesh janë përdorur tuba me përmasa Ø 300. Me këtë përgjegjësi dhe angazhim, Bashkia, si institucioni që ka lidhje të drejtpërdrejta me qytetarët dhe problematikave të tyre, ka hartuar dhjetëra projekte në fusha jetike. Një ndër to është edhe ndërtimi i kanalizimeve në rrugët e Kamzës dhe të Paskuqanit. Vetëm këtë vit janë mbi 70 projekte që janë parashikuar të realizohen brenda territorit të Bashkisë Kamëz.

## Përfundon prokurimi për ndërtimin e rrugës "Prizreni" në Frutikulturë, së shpejti nis punimet



Ka përfunduar procedura e prokurimit për ndërtimin e rrugës "Prizreni" në Frutikulturë, kështu që së shpejti do të nis punimet. Ndërtimi i rrugës "Prizreni", me gjatësi 700 metra linearë, është një prej 70 projekteve të planifikuara të vitit 2018, që financonet me të ardhurat e Bashkisë. Ky investim nuk do të jetë i vetmi, si në Frutikulturë ashtu edhe në gjithë territorin e Kamzës, krahas investimeve madhore e të rëndësishme që janë në ndërtim e sipër. Në këtë mënyrë vijon tradita e shkëlqyer e Bashkisë Kamëz për të realizuar investime publike në fusha jetike për banorët, kjo edhe në një kohë kur qeveria nuk ka akorduar asnjë qindarkë për pesë vite me radhë për qytetarët dhe Bashkinë e Kamzës. Janë mbi 130 projekte në dy vitet e fundit, të shpërndara në të gjitha lagjet dhe zonat e Kamzës dhe Paskuqanit, duke iu përgjigjur kërkesave më emergjente të banorëve.

## Mbi 130 projekte ka financuar në dy vite Bashkia Kamëz, mes tyre KUN në rrugën "Tropoja", Laknas



Mbi 130 projekte ka financuar në dy vitet e fundit Bashkia Kamëz. Mes tyre është edhe ai për ndërtimin e kanalizimeve në rrugën "Tropoja", i cili përbën një investim të dobishëm për banorët e kësaj zone në Laknas. Janë mbi 130 projekte të reja të hartuara nga Bashkia në vitin 2017 dhe në vitin 2018, me qëllimin për të ndërtuar një infrastrukturë bashkëkohore. Kjo është një nga detyrat e rëndësishme të Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Investimeve Publike e Rrugëve.

Kryesisht këto investime me interes të lartë publik kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve, me ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve, rikonstruksionin e shkollave dhe kopshteve. Realizimi i këtyre investimeve të rëndësishme bëhet i mundur falë një buxheti, pjesa më e madhe e të cilit shkon për investime. Është një buxhet i cili në thelbin e vet ka infrastrukturën, sepse qyteti i Kamzës mbetet një qytet në nevojë për ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës. Kështu, duke qenë se qeveria e majtë për pesë vjet nuk akordon asnjë qindarkë për projektet e Kamzës, ka qenë Bashkia, e cila ka shfrytëzuar çdo burim që të financojë projekte jetike për qytetarët. Politika e Bashkisë Kamëz është që të jetë pranë qytetarëve në çdo cep të qytetit me investime të rëndësishme. Edhe gjatë takimeve që organizon kryebashkiaku Xhelal Mziu me qytetarët, si nëpër lagje, por edhe gjatë takimeve të së premtës, u kërkon që të jenë sa më bashkëpunues për krijimin e një infrastrukture urbane të denjë për një qytet urban.

## Një tjetër rrugë e prokuruar, e gatshme për të filluar ndërtimin, rruga "Sali Murat Vranishti" në Babrru-Kodër



Një tjetër rrugë tashmë është e prokuruar dhe e gatshme për të filluar ndërtimin e saj. Bëhet fjalë për rrugën "Sali Murat Vranishti" në Babrru-Kodër, e gjatë 630 metra.

Kështu, në Babrru-Kodër së shpejti do të fillojnë punimet për realizimin e këtij projekti. Ky është një tjetër investim i Bashkisë Kamëz i planifikuar për vitin 2018. Me të ardhurat e veta Bashkia financon këtë projekt të rëndësishëm për banorët e zonës, të cilët e kanë vuajtur mungesën e investimeve dhe të infrastrukturës urbane. Kanë qenë pikërisht kërkesat e qytetarëve, të cilat janë marrë parasysh nga ana e Bashkisë Kamëz për të hartuar dhe për të zbatuar gjatë këtij viti projektin e ndërtimit të rrugës "Sali Murat Vranishti" në Babrru-Kodër.

Segmenti rrugor ku do të investohet, do të ketë standarde bashkëkohore, me qëllimin për të ofruar më të mirën për qytetarët.

## Së shpejti nis ndërtimi i trotuareve te rruga "Bujar Lako", pas procedurave të prokurimit



Për një sërë projektesh të Bashkisë Kamëz, të planifikuara për vitin 2018, kanë përfunduar procedurat e prokurimit, kështu që së shpejti do të nis punimet për realizimin e tyre. Një nga këto projekte është edhe ndërtimi i trotuareve në rrugën "Bujar Lako", Zall-Mner. Gjatësia e rrugës ku do të ndërhyhet me këtë investim është 240 metra linearë dhe gjerësia e trotuareve 2 metra. Rruga "Bujar Lako" ka një vlerë të madhe, pasi bën lidhjen e Zall-Mnerit me Bulevardin Blu, duke u shërbyer kështu mijëra qytetarëve. Bashkia është e angazhuar për të ndërtuar një infrastrukturë me standarde bashkëkohore dhe vlerëson çdo element të saj, duke filluar që nga rrugët, trotuaret, ujësjellësi, kanalizimet, rikonstruksionin i kopshteve dhe i shkollave etj. Edhe ky projekt, që do të realizohet tërësisht nga të ardhurat e Bashkisë, është në kuadrin e urbanizimit të mëtejshëm të lagjeve të qytetit. Duke qenë se nga ana e qeverisë nuk është financuar asnjë projekt në fusha jetike për qytetarët e Kamzës, është Bashkia që ka marrë përsipër, me çdo mundësi, që të jetë pranë tyre me investime themelore e të rëndësishme.





## Projekti i ujësjellësit, takim i kryebashkiakut Mziu me konsulentin Jaap Boomsma për rezultatet e arritura

*Prej konsulentit Jaap Boomsma u morën garancitë që brenda këtij viti fillon zbatimi i fazave 3-4 të projektit*

Kryebashkiaku Xhelal Mziu priti në një takim progresi ekspertin për praktikant më të mira të menaxhimit financiar të Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve z. Jaap Boomsma, konsulent dhe drejtues i lartë i programit "Infrastruktura Bashkiake III dhe IV". Në këtë takim pune u diskutua për rezultatet e arritura, situatën aktuale të ujësjellësit si dhe çfarë duhet të bëhet për të ardhmen për furnizimin me ujë të të gjithë qytetarëve të Kamzës.

Vlen të theksohet se gjatë këtij takimi prej konsulentit Jaap Boomsma u morën garancitë që brenda këtij viti fillon zbatimi i fazave 3-4 të projektit të ujësjellësit. Gjithashtu, gjatë bashkëbisedimit u arrit në përfundimin që ndërmarrja së shpejti do të kalojë në shoqëri aksionere.

Kryebashkiaku Mziu, pasi falënderoi z. Boomsma, i bëri me dije që pavarësisht se Kamza furnizohet me të njëjtën sasi uji, ka rritje të performancës së ndërmarrjes, kjo për shkak të mirëmenaxhimit të



ndërmarrjes në shërbim të qytetarëve, si dhe për shkak të përvojës dhe kualifikimit të burimeve njerëzore. "Në vlerë financiare jemi në rekord në Shqipëri për sa i përket performancës së saj. Furnizimi me ujë i qytetarëve është prioritet parësor për të gjithë.



Ndërmarrja ka luajtur këtë funksion me të njëjtën sasi uji, duke shtuar kontratat e reja, të gjitha me forcat tona. Asnjë qindarkë nga qeveria, as për ujësjellësin, dhe as për rrjetin e kanalizimeve, kështu që së pari kërkoj nga ana juaj të ushtroni ndikim ndaj qeverisë për financime si dhe të fillojë faza tjetër sa më shpejt", - theksoi ndër të tjera z. Mziu gjatë takimit me konsulentin Jaap Boomsma të mbajtur në zyrën e tij.

### Nëpunësit e Rajonit Bathore, korrektësi në zbatimin e detyrave të lëna

Nëpunësit e Rajonit Bathore kanë qenë korrekt me detyrat e lëna përgjatë periudhës aktuale dhe në vazhdim.

Nga punonjësit e kësaj strukture ka pasur një angazhim maksimal për mbarëvajtjen e punës në Rajonin Bathore për 6-mujorin e vitit 2018.

Kjo periudhë është karakterizuar nga zbatimin korrekt i detyrave të dala nga institucioni i Bashkisë, si dhe nga koordinimi dhe bashkëpunimi efektiv midis zyrave të Rajonit Bathore dhe drejtorive përkatëse pranë Bashkisë.

Kështu, zyra e Gjendjes Civile në Rajonin Bathore, përveç dhënies së certifikatave dhe vërtetimeve, është e angazhuar në sistemimin e adresave dhe kthimin e përgjigjeve të shkresave

të ndryshme, duke qenë korrekte në zbatimin me përpikëri të detyrave. Ndërkaq, zyra e Ndhmës Ekonomike ka vijuar punën për të ofruar shërbimin ndaj familjeve dhe individëve në nevojë. Edhe zyra e Shërbimeve Publike ka pasur një angazhim maksimal në kryerjen e detyrave që i ngarkon ligji, si dhe ka pasur bashkëpunim efektiv me drejtoritë e tjera për kryerjen sa më mirë të shërbimit ndaj komunitetit. Gjithashtu, edhe zyra e Taksave Familjare dhe Ujësjellësit ka kryer detyrat funksionale që ngarkon ligji për vjeljen e taksave familjare dhe të debisë së prapambetur. Punonjësit e kësaj zyre gjithashtu kanë bërë njoftimin e debitorëve për debitë e prapambetura.

### Njësia Administrative e Paskuqanit, e angazhuar për të realizuar objektivat

Njësia Administrative e Paskuqanit është angazhuar totalisht për të arritur objektivat e caktuar në fillim të vitit. Sigurisht në plan të parë është rritja e kapaciteteve të shërbimit në çdo aspekt për qytetarët e kësaj njësie, të cilët kanë nevojat e tyre për t'i plotësuar.

Për këtë, duke ditur që kjo njësi ka vetëm 3 vjet që i është bashkëngjitur institucionit Bashkia Kamëz, është projektuar një vizion që t'u jepet përparësi kryesisht investimeve dhe shërbimeve për t'u përafuar ritmeve të zhvillimit që ka pasur qyteti i Kamzës në këto vite ndryshimi rrënjësor.

Për të realizuar këto objektiva kryebashkiaku Xhelal Mziu ka kërkuar nga strukturat e kësaj njësie në veçanti të rritin kapacitetet dhe burimet e njohura dhe të ndryshme për të arritur tregues financiarë në shërbim të buxhetit dhe sigurisht

të përkthyer këto në investime dhe shërbime. Struktura funksionale është gërshtuar me të gjithë pjesën aktive të Bashkisë Kamëz për krijimin e grupeve të terrenit për të komunikuar dhe bashkëbiseduar me qytetarët për rëndësinë që paraqet çdo qindarkë e mbledhur dhe për të realizuar shërbime tërësore ndaj qytetarëve.

Kjo periudhë shënon një përmirësim të ndjeshëm si në infrastrukturë dhe shërbime, falë politikave nxitëse që Bashkia ka aplikuar në këto vite, sidomos në Njësinë Administrative të Paskuqanit. Krahasuar me periudha të njëjta të viteve të kaluara, periudha e tanishme sheh përmirësime të dukshme në të gjitha drejtimet e punëve menaxhuese, por duhet një punë akoma më e madhe për të qenë më pranë qytetarëve për t'u shërbyer në kohë dhe me cilësi.

### Riparimi i dëmtimeve në rrjet, një nga punët më të dobishme të punonjësve të Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve

Riparimi i dëmtimeve në rrjet është një nga punët më të dobishme të punonjësve të Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve. Në këtë periudhë të vitit, krahas detyrave të shumta funksionale që ka kjo ndërmarrje, është edhe riparimi i defekteve të ndryshme në rrjetin e ujësjellësit si dhe në atë të kanalizimeve. Kështu, gjatë kësaj periudhe nga ana e punonjësve të ndërmarrjes janë riparuar defekte në lagjen Paskuqan 2, si dhe është bërë riparimi i saraçineskës së manovrimit të ujit të rrethrotullimi në qendër të Kamzës, gjë që bëri të mundur rikthimin e furnizimit me ujë për zonat, të cilat furnizohen nga mekanizmi i kësaj pikëshpërndarjeje.

Dega teknike në terren përgatit të dhënat për dokumentacionin teknik për punimet e kryera në çdo sektor në raste defektesh në furnizim dhe shpërndarje si

dhe ndikon për kryerjen me cilësi të riparimeve. Sektori i KUN vazhdon të jetë eficient gjatë gjithë kohës, duke mbajtur gjithmonë në kontroll funksionimin e kolektorëve, të pushtave kulluese si dhe në përbalimin e situatave të mundshme të përmbytjeve. Ankesave të abonentëve për problematikat e KUN, si: zhbllokim, pastrim apo riparim rrjeti, u është dhënë zgjidhje të menjëhershme. Janë bërë gjithashtu edhe riparime të pjesshme, si hapje kolektori, vendosje e tubave të shkarkimit, vendosje kapakësh pushtash, pastrim i zgarave të pushtave të rrugëve etj. Kjo gjendje vigjilence në këto ditë të lagështa të periudhës aktuale ka bërë që e gjithë Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve të ruajë gatishmërinë për shërbime cilësore për qytetarët në këta sektorë.





## Të dhënat pozitive për 6-mujorin, tregues premtues për realizimin e objektivave nga ana e Bashkisë Kamëz

Korrik 2018  
GAZETA KAMZA

5



Kryebashkiaku Xhelal Mziu ka mbledhur në një takim pune të gjitha strukturat drejtuese të institucionit për të paraqitur ecurinë e punëve në Bashkinë Kamëz. Pas një relatimi të hapur nga ana e drejtuesve të drejtorive për performancën reale të treguesve të realizuar si 6-mujor, të dhënat janë premtuese. Në të gjithë sektorët e shërbimeve ka një përparim të dukshëm, por mbetet akoma shumë për t'u bërë.

“Edhe pse në 6-mujorin e parë të vitit kemi kuota mjaft premtuese për realizimin e buxhetit dhe për rrjedhojë jemi me objektiva të qartë për të realizuar investimet dhe shërbimet në të cilët sigurisht që do të jenë përfitues qytetarët e Kamzës. Që në projektbuxhet janë parashikuar që 60% e të ardhurave të siguruar do të shkojnë tërësisht për investime, një politikë që vazhdon prej vitesh që të zbatohet, një realitet si në asnjë qeverisje tjetër vendore në vend. Megjithatë situata është optimiste, - theksoi kryebashkiaku Mziu në këtë takim, - do të vazhdojë puna pa ndërprerje për përmirësimin e situatës debitore, duke përdorur instrumentet ligjore për të sjellë një përmirësim të situatës së deritanishme. Nëpërmjet strukturave të Bashkisë që do të jenë të gjitha të angazhuara do të bëhet i mundur krijimi i një partneriteti të duhur, të hapur për bashkëpunim dhe një tolerancë zero ndaj debive të mbartura. Jemi në një kohë që vetë qytetarët kanë nevojë për të marrë shërbimet e duhura dhe për këtë kërkoj angazhimin maksimal për të shpërndarë interesimin e duhur ndaj qytetarëve të Bashkisë Kamëz në çdo aspekt ndihmese që ata kanë nevojë të jenë përfitues të rregullt ligjorë”, - përfundoi fjalën e tij kryebashkiaku Mziu.

Edhe kjo periudhë kohore, ashtu si pesë vite me radhë, për Bashkinë Kamëz shënoi sërish deficienat e financimeve nga ana e qeverisë qendrore, e cila mbeti në zbatimin e politikave të qarta diskriminuese ndaj qytetarëve të Kamzës. Duke



parë këtë gjendje dhe këtë indiferencë, Bashkia Kamëz ka shfrytëzuar të gjitha burimet e mundshme për financimin e investimeve publike apo shërbimeve të tjera. Edhe pse një periudhë mjaft e vështirë për qytetarët e Kamzës, u ruajt trendi i investimeve në territorin e Bashkisë, duke dërguar 60% të buxhetit për investime.

Ky vizion ka bërë që brenda një kohe mjaft të shkurtër për afro 10 vjet të shndërrohet tërësisht në zonë urbane qytetin e Kamzës. Investimet e planifikuara janë realizuar 100% nga të ardhurat e Bashkisë. Vlen të përmenden investime me rëndësi dhe impakt të jashtëzakonshëm në territorin e Bashkisë, siç janë dy bulevardet kryesore, bulevardi “Trump” në Kamëz si dhe bulevardi “Demokracia” në Njësinë Administrative Paskuqan. Buxheti i Bashkisë është i fokusuar edhe në të tjera investime publike, si: rrugë të brendshme, kanalizime, rehabilitim sheshesh,

*“ Bashkia Kamëz ka shfrytëzuar të gjitha burimet e mundshme për financimin e investimeve publike apo shërbimeve të tjera. Edhe pse një periudhë mjaft e vështirë për qytetarët e Kamzës, u ruajt trendi i investimeve në territorin e Bashkisë, duke dërguar 60% të buxhetit për investime. ”*

gjelbërim etj. Bashkia ka arritur të hartojë një buxhet si asnjë njësi tjetër vendore, duke pasur në qendër të tij komunitetin. Për këtë janë shfrytëzuar të gjitha burimet e mundshme për të pasur të ardhura, të cilat konvertohen në investime dhe në shërbime ndaj qytetarëve.

### Policia Bashkiake, në gatishmëri për zbatimin e detyrave

**Në vijimësi është realizuar lirimi i hapësirave publike në bashkëpunim me IVMT-në, duke bërë të mundur krijimin e infrastrukturës të planifikuar për investime**

Policia Bashkiake ka vijuar këto ditë punën për të realizuar jo vetëm detyrat funksionale të saj, por edhe bashkëpunimin e ngushtë me drejtoritë e tjera të Bashkisë Kamëz. Në vijimësi është realizuar lirimi i hapësirave publike në bashkëpunim me IVMT-në, duke bërë të mundur krijimin e infrastrukturës të planifikuar për investime. Kjo punë ka pasur efikasitetin e duhur, duke bashkëpunuar edhe me qytetarët, të interesuar për përfitimin e investimit, duke ndihmuar në lehtësimin e punëve për realizimin e qëllimit kryesor.

Struktura e Policisë Bashkiake çdo ditë është organizuar për lirimin e trotuareve me masa konkrete si dhe në bashkëpunim me inspektorët e Drejtorisë së Transportit po ndjek zbatimin dhe disiplinimin e parkingjeve tashmë funksionale për segmentet rrugore, të cilët janë miratuar nga ana e Këshillit Bashkiak që

do të shërbejnë për qëndrimin e mjeteve në përkujdesje të shërbimeve që do të marrin në vetvete. Kjo nismë e marrë nga Bashkia ka bërë të mundur të disiplinohet jo vetëm qëndrimin e mjeteve në vende të caktuara, por edhe disiplinimin e trafikut në rrugët kryesore të qytetit Kamëz. Zbatimi i ligjit dhe krijimi i një rregulli për mirëfunksionimin e jetës në qytet është detyra themelore që Policia Bashkiake vazhdon të mbështesë në misionin e saj. Puna e Policisë Bashkiake ka qenë rezultative në shumë drejtime dhe roli i saj, si forcë ekzekutive në ndihmë të ushtrimit të funksioneve të organeve dhe strukturave të Bashkisë, ka qenë i rëndësishëm. Një faktor kyç në arritjen e rezultateve dhe përmbushjen e objektivave mbetet bashkëpunimi i kësaj strukture me drejtorin dhe sektorët e ndryshëm të administratës së Bashkisë Kamëz.



### Mbledhja e Këshillit Bashkiak, miratohet projektbuxheti afatmesëm, si dhe projektvendime të tjera

Ditën e premte, në datën 22.6.2018, në sallën e mbledhjeve të Këshillit pranë Bashkisë Kamëz u zhvillua mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Kamëz. Gjatë kësaj mbledhjeje u miratuan një sërë projektvendimesh të rendit të ditës. Mes tyre u miratua projektvendimi “Për miratimin e projektbuxhetit afatmesëm” për periudhën 2019-2020-2021”, si dhe projektvendimi “Për ndryshimin e emërimit të rrugës “Burreli” në rruga “Nikoll Pjetër Vatnikaj”. Ndërkaq, u miratuan edhe disa projektvendime të tjera, siç është projektvendimi nr. 60, dt. 14.6.2018 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 1- 30.6.2018 Kamëz dhe Paskuqan”; projektvendimi nr. 61, dt. 14.4.2018 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 1- 30.6.2018 për personat me aftësi të kufizuara dhe invalidët e punës”; projektvendimi nr. 62, dt. 14.4.2018 “Për dhënien e kompensimit të energjisë elektrike maj 2018”; projektvendimi nr. 63, dt. 14.4.2018 “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% i familjeve që nuk kanë përfituar nga sistemi elektronik i pikëzimit për muajin qershor 2018”; projektvendimi nr. 64. dt. 14.4.2018 “Për rastet e veçanta qershor 2018”; lënie në fuqi të VKB-ve nr. 77, 78 datë 24.5.2018







## Krijohet Këshilli Lokal i Paqes në Bashkinë Kamëz

Në sallën e Këshillit Bashkiak Kamëz u organizua një takim i zgjeruar për ngritjen e Këshillit Lokal të Paqes në këtë qytet. Në këtë takim ishin të pranishëm kryebashkiaku Xhelal Mziu, z. Michael Balcomb, kryetar i Federatës së Paqes për Evropën dhe Euroazinë; z. Jack Corley, kryetar i Federatës së Paqes Universale për Euroazinë; z. Gaqo Apostoli, kryetar i Federatës së Paqes Universale Shqipëri; Saemira Pino, anëtare e Këshillit Drejtues të Federatës së Paqes Universale.

Paraprakisht, z. Mziu e priti përfaqësinë e Federatës së Paqes Universale në zyrën e tij, duke bërë një prezantim të shkurtër të zhvillimit të qytetit të Kamzës në këto 22 vite. Kamza njihet për zhvillimet si qyteti më i ri në Shqipëri, duke qenë qyteti që ka zhvillimin më të shpejtë në infrastrukturë si dhe në elemente të zhvillimit social e kulturor. Partneriteti me institucione të qenësishme, me kapacitete shumë të

fuqishme financiare si Banka Botërore, Këshilli i Evropës, UNDP-ja dhe KfW-ja, por edhe partneritete të tjera të gjera me qytete të tjera evropiane kanë bërë që zhvillimi të jetë mjaft i ndjeshëm. Moshë më e re mesatare në nivel kombëtar është një tjetër epërsi që qyteti mbart si një ogur për këtë lloj vitaliteti. Një përparësi që e ofron zhvillimin e Kamzës është edhe pozicioni gjeografik, theksoi gjithashtu kryebashkiaku Mziu, i cili ravijëzoi fjalën e tij përmbjllëse, duke siguruar të pranishmit që ky është qyteti që është populluar nga të gjitha krahinat e vendit tonë, të cilët jetojnë në një harmoni të theksuar komunitare, duke respektuar edhe harmoninë fetare.

Përfaqësuesit e Këshillit të Paqes Universale vlerësuan mikpritjen dhe falënderuan kryebashkiakun Mziu për kontributin e tij në ndryshimin e imazhit të qytetit. “Ne së bashku do të bëjmë shumë gjëra që ky qytet të



bëhet qendra e paqes për Shqipërinë”, - thanë ata. Moderator i këtij takimi, sekretari i përgjithshëm i Bashkisë Kamëz, z. Qemal Çejku, bëri edhe prezantimin e vlerësimit të ambasadorëve për

**“Përfaqësuesit e Këshillit të Paqes Universale vlerësuan mikpritjen dhe falënderuan kryebashkiakun Mziu për kontributin e tij në ndryshimin e imazhit të qytetit. “Ne së bashku do të bëjmë shumë gjëra që ky qytet të bëhet qendra e paqes për Shqipërinë”, - thanë ata.**

qytetin e Kamzës, figura mjaft të njohura intelektuale dhe kontribuuese, duke i vlerësuar me certifikata “Ambasadorë për Paqen”. Pas vlerësimit të këtyre autoriteteve me mirënjohje, u kalua në zgjedhjen e Këshillit Lokal të Paqes në Kamëz, ku kryetar u zgjodh z. Qemal Çejku. Takimi u mbyll në shenjë të dashurisë për paqen, duke iu referuar misionares për paqen, Nënë Tereza.



### Fotolajm

**Vizitë pune e kryebashkiakut Xhelal Mziu në Komunën Castenaso në Itali, qytet i binjakëzuar me Kamzën, me ftesë të kolegut Stefano Sermenghi**



### Marrëveshjet dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, ecure pozitive e Bashkisë Kamëz drejt proceseve integruese

Marrëveshjet dhe marrëdhëniet ndërkombëtare kanë shënuar ecure pozitive të Bashkisë Kamëz drejt proceseve integruese. Viti 2018 shënoi 10-vjetorin e krijimit të Drejtorisë së Koordinimit-Zhvillimit të Projekteve dhe Protokollit Ceremonial në Bashkinë Kamëz. Gjatë kësaj periudhe, vlen për t'u theksuar suksesi që ka pasur qyteti dhe Bashkia e Kamzës, falë punës së kësaj drejtorie. Drejtorja e Koordinimit, Zhvillimit të Projekteve dhe Protokollit Ceremonial u ngrit si drejtori në vitin 2008, me këto funksione kryesore: koordinimi i punës për ndërtimin e programeve të zhvillimit dhe hartimit të projekteve për realizimin e tyre; organizimi

i korrespondencave, kontakteve dhe bashkëpunimeve në arritjen e partneriteteve dhe binjakëzimeve me bashki e qytete që janë pjesë e BE-së, atyre rajonale dhe botërore; bashkëpunimi i kësaj drejtorie me drejtoritë e tjera për marrjen e informacionit, plotësimin, përkthimin, arkivimin e një dokumentacioni të gjithanshëm, të kërkuar nga donatorë e institucione të rëndësishme ndërkombëtare për projekte zhvilluese, si Komisioni Evropian, Këshilli Evropës, USAID, UNDP si dhe institucionet qendrore; promovimi i performancës së Bashkisë jo vetëm në nivel kombëtar, por veçanërisht atë ndërkombëtar; ndjekja e axhendës së institucionit në funksion të realizimit të aktiviteteve të ndryshme, siç

janë qenë ceremonitë inauguruese, pritjet e delegacioneve, aktivitetet kulturore, festive, sportive etj. Numërohen me dhjetëra binjakëzime me bashki e qytete të Bashkimit Evropian dhe më gjerë; aplikimi dhe pjesëmarrja në projekte të rëndësishme të financuara nga organizmat ndërkombëtarë si rezultat i rritjes të binjakëzimeve të Bashkisë Kamëz. Kjo është arritur falë një platforme pune, e cila është ngritur në 4 prioritetet: prioriteti për zhvillimin e projekteve; prioriteti për thithjen e investimeve të huaja; prioriteti për aplikimin e projekteve në Komisionin Evropian dhe në programe të tjera financiare; prioriteti për zgjerimin e bashkëpunimeve dhe binjakëzimeve.

### Nafta, 110 lekë vetëm taksat. Shqipëria, e 13-ta në botë për çmimin më të lartë

Shqipëria renditet në tri vendet e fundit të Evropës për nga zhvillimi ekonomik, por ka një tregues ku ajo konkurren me ekonominë më të pasura të planetit, ai është çmimi i lartë i naftës.

Sipas Global Petroleum Prices, aktualisht Shqipëria është vendi i 13-të me çmimin më të lartë të naftës në botë. Qytetarë shqiptarë paguajnë mesatarisht 178 lekë ose 1.65 dollarë për një litër naftë, kur në Gjermani, Austri apo Holandë, çmimi është dukshëm më i ulët, arsyeja e këtij absurdi është qeveria. “Sepse sistemi i taksave që ne përdorim në karburante është më i larti dhe kemi disa taksat

të veçanta që nuk aplikohen në vende të tjera. Çmimi i lartë vjen nga taksat që përfshihen në kosto”, - shprehet Luigj Aliaj, Shoqata e Hidrokarbureve.

Në çdo litër naftë, që paguhet rreth 180 lekë, mbi 100 lekë shkojnë për qeverinë, ndërsa pjesa tjetër është kosto për naftën. Kjo bën që çmimi të mos ulet asnjëherë edhe sikur nafta në bursa të shitet falas. “Nafta me çmimin që del sot nga bursat ndërkombëtare përfshirë transportin, shpenzimet e shpërndarjes dhe fitimin e kompanive ka një çmim mes 70-75 lekësh, gjithë pjesa tjetër është taksat”, - shprehet Aliaj. Por me gjithë këtë barrë të

rëndë, qeveria vazhdon të shtojë taksat mbi karburantet, tani edhe përmes koncesioneve. Më e reja pritet të vijë shumë shpejt.

“Së fundmi po përgatitet edhe një taksë që do i kalojë privatit, për kontrollin e pompave të karburantit, e cila do të jetë një kosto shtesë për çmimin e lartë”, - shton z. Aliaj.

Shumë ekspertë thonë se çmimi i lartë i karburanteve ka dëmtuar jo pak ekonominë duke i bërë bizneset shqiptare më pak konkurruese krahasuar me ato të vendeve të ngjashme fqinje, ku nafta kushton shumë më pak, si në Maqedoni, ku çmimi i naftës është mesatarisht 130 lekë.







## Kamza e 6-ta për popullsinë në vend, por Bashkia me më pak familje të trajtuar me ndihmë ekonomike



Fondi i ndihmës ekonomike ndër vite



Numri i përfituesve në ndër vite



**Krahasuar me 5 vite më parë numri i familjeve që trajtoheshin me ndihmë ekonomike ishte rreth 7000 familje, ndërsa sot kemi rreth 700 familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, që do të thotë rreth 10 herë më pak familje të trajtuara**

Sa vjen e minimizohet ndihma ekonomike ndaj familjeve në nevojë në Kamëz. Edhe pse Bashkia Kamëz renditet e 6-ta në vend për nga numri i popullsisë, është Bashkia me më pak familje të trajtuar me ndihmë ekonomike.

Ka një progresion të rregullt të kujdesit ndaj largimit nga trajtimi me ndihmë ekonomike të familjeve dhe familjarëve në këtë Bashki. Kjo politikë siguron që është mbarëkombëtare, por Kamza shikohet me lupën e kujdesit qeveritar se mos i rriten ndopak kushtet e jetesës së tyre.

Kjo politikë diskriminuese që qeveria shqiptare u ka servirur qytetarëve të Kamzës duket më se e qartë.

Kështu, gjatë muajit maj janë larguar nga skema e ndihmës ekonomike 402 familje nga 1187 familje që ishin përfitues gjatë muajit prill që do të thotë rreth 35% vetëm në krahasim 1-mujor. Po e njëjta gjë ka ndodhur edhe për muajin qershor, kur kanë aplikuar 890 familje dhe kanë përfituar ndihmën ekonomike rreth 548 familje, që do të thotë i njëjti trend i reduktimit të familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike.

Kjo ulje e numrit të familjeve që largohen nga skema e ndihmës ekonomike e ka zanafillën te sistemi, i cili vazhdon të aplikojë mendjen djallëzore për të dhënë vlerësime të paimagjinueshme.

Edhe pse ka një planifikim ku i lihet hapësirë Bashkisë që të rrisë trajtimin e familjeve më në nevojë të target-grupit që institucioni i ka të pikasur përsëri ky 6% i referohet numrit

të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, ku nga kjo statistikë mund të përfitojnë nga 35-40 familje që do të thotë një grup sociale mjaft e thellë.

Krahasuar me 5 vite më parë, numri i familjeve që trajtoheshin me ndihmë ekonomike ishte rreth 7000 familje, ndërsa sot kemi rreth 700 familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, që do të thotë rreth 10 herë më pak familje të trajtuara.

Edhe një fakt tjetër edhe pse 5 vite më parë numëroheshin rreth 21.000 familje, sot në Bashkinë e Kamzës jetojnë rreth 40.000 familje. Kjo është politika dhe strategjia sociale e qeverisë Shqiptare që më shumë gjasa ka ta eliminojë tërësisht skemën e ndihmës ekonomike në një kohë shumë të shkurtë r dhe siguron pasojë është rritja e tejkajshme e varfërisë në të gjithë vendin por sidomos në Kamëz.

**Në një periudhë kohore prej 6 muajsh largohen 3013 familje nga skema e ndihmës ekonomike në Kamëz**

Shkak i largimit të tyre është për mosparaqitje e familjeve të larguara te Zyra e Punës. Që prej vitit 2013, Zyra e Punës është larguar nga sportelet e shërbimit në Bashkinë Kamëz dhe është zhvendosur në ambiente private që kanë shërbyer si shtabë elektorale të Partisë Socialiste deri më shkurt të vitit 2017 dhe që prej kësaj kohe është transferuar në Zyrat e Punës në Tiranë, Shërbimi Social, dhe mendohet që po të transferohet në Qendrën Ditore, Bashkia Tiranë.

Është handicap i hapur që qytetarët e Kamzës të marrin shërbim në Bashkinë e Tiranës pranë zyrës së punës. Është njësoj sikur qytetarët e Bashkisë së Vlorës të marrin shërbim në Bashkinë e Fierit.

Bashkia Kamëz i ka ofruar në mënyrë të përhershme



Çështjet sociale janë trajtuar me shumë kujdes dhe kanë marrë vëmendjen e veçantë të Bashkisë Kamëz. Pavarësisht nga mungesa e fondeve të akorduara nga qeveria, Bashkia ka shfrytëzuar çdo burim për t'iu gjendur pranë shtresave më në nevojë të qytetit. Nga 7000 familje përfituese të ndihmës ekonomike, viti 2017 solli një ulje drastike të familjeve përfituese të saj.

**Ndihma ekonomike është një sistem shërbimi që u përket institucioneve të qeverisë qendrore, një kompetencë tashmë e hequr për pushtetin vendor, duke rritur në mënyrë të ndjeshme numrin e familjeve të varfra dhe përkatësisht varfërinë në Kamëz. Diskriminimi i qytetarëve të Kamzës ka qenë motoja e qeverisë qendrore për qytetarët e Kamzës.**



Zyrës së Punës zyrë dhe ambiente të përshtatshme shërbimi në sportelet e One Stop Shop-it, por këto ambiente nuk janë pranuar nga Shërbimi Social, por politikisht janë penalizuar këto familje dhe vazhdojnë të penalizohen. Për vetë nivelin social të këtij grupi familjar, të cilët e kanë të pamundur lëvizjen dhe paraqitjen në Laprakë e Tiranë, kërkohet që Zyra e Punës të jetë në shërbim të familjeve dhe familjarëve në nevojë dhe të shërbejë në sportelet e One Stop Shop-it, Bashkia Kamëz.

## Në Bashkinë Kamëz u organizua takim për parandalimin e dhunës ndaj të miturve



Në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak të Kamëz është organizuar takimi i radhës me përfaqësues të institucioneve vendore dhe qendrore për masat e koordinuara që do të hartohen për minimizimin e parandalimit të dhunës ndaj të miturve në këtë Bashki.

Koordinatori vendor për dhunë në Bashkinë Kamëz në bashkëpunim me QDNJD në kuadër të zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit "Për riaktivizimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij (në vazhdim i quajtur "Mekanizmi referues"), që ka si objekt kryesor mbështetjen e funksionimit

të referimit në Bashkinë Kamëz me qëllim menaxhimin në mënyrë të koordinuar të rasteve të dhunës kundër grave dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse për gratë dhe vajzat bën të mundur sot të trajtohen rastet e ndodhura në familjet e territorit të Bashkisë Kamëz.

Në këtë takim të gjithë të pranishmit pranuan rastet e ndodhura dhe së bashku ranë në një emërues të përbashkët për të marrë masat e duhura dhe përgjegjësitë reale në këtë fenomen i cili është mjaft i ndjeshëm në çdo familje. Bashkia Kamëz e ka vlerësuar këtë fenomen duke u ardhur në ndihmë me koordinim në të cilin Bashkia e cila e ka miratuar në organigramë një strukturë të posaçme për këtë gjë.





## Kryebashkiaku Mziu, i pranishëm në promovimin e librit kushtuar Gani Cahanit të autorit Esat Bytyçi

**Mziu: Sot kam nderin të nderoj me “Certifikatë Mirënjohjeje” z. Gani Cahani**



Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, mori pjesë në promovimin e librit me titull “Kur thërret shpirti artistit” kushtuar Gani Cahanit, me autor Esat Bytyçin. Në fjalën e tij përshëndetëse, z. Mziu vlerësoi autorin për sjelljen e kësaj risie në ambientet e Pallatit të Kulturës së Kamzës, i cili tashmë është kthyer edhe në këto ditë të nxehta vere në një arenë të aktiviteteve me vlerë të pakrahasueshme promovimesh të veprave artistike. “Gani Cahani mbetet një ndër aktorët e rëndësishëm të komunitetit të Kamzës, - theksoi

kryebashkiaku Mziu, - dhe si i tillë është pjesë e ndryshimeve rrënjësore që qyteti i Kamzës ka pësuar pas viteve 1990, duke u bërë lëvizje shumë aktive në kontributin e dhënë për zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit. Si një familje me vlera të mëdha kontribuuese si dhe në shpirtin e një artisti të vërtetë, sot kam nderin të nderoj me “Certifikatë Mirënjohjeje” z. Gani Cahani. Të tilla ceremoni do të zhvillohen në dyert e hapura të Pallatit të Kulturës në Kamëz, do të mbahen gjithnjë në të ardhmen për të vlerësuar dhe promovuar vlerat

e qytetit të Kamzës”, - theksoi kryebashkiaku Mziu në fjalën e tij përmbyllëse. Gjithashtu ai vlerësoi certifikatë edhe autorin e shumë librave dhe më së fundmi atë me titull “Kur thërret shpirti artistit”, kushtuar Gani Cahanit, biografi e letrarizuar, z. Esat Bytyçi. Libri “Kur thërret shpirti i artistit” kushtuar Gani Cahanit i autorit Esat Bytyçi, përfshin të gjithë aktivitetin kulturor dhe artistik të tij. Libri përmban rrëfime, poezi, si dhe pjesë nga e gjithë veprimtaria e Gani Cahanit bazuar në fakte dhe dokumente të kohës.

## Brenda një muaji, veprimtari të shumta në Pallatin e Kulturës Kamëz



Brenda një periudhe njëmuajore, janë zhvilluar veprimtari të shumta në Pallatin e Kulturës Kamëz. Ka qenë një periudhë e ngjeshur me veprimtari të shumëllojshme, të cilat janë zhvilluar në mjediset e këtij pallati, si në skenën e teatrit, në sallat e konferencave etj. E rëndësishme është të përmendet larmia e tyre dhe përkushtimi për t'i realizuar ato, që nga stafi i Pallatit të Kulturës, bashkëpunimi me organizata, shoqata, shoqëri artistike, ansamble, shkolla, trupa teatrale etj. Të gjitha këto të realizuara edhe me kujdesin e veçantë të kryebashkiakut Xhelal Mziu, i cili në çdo veprimtari fton publikisht këdo për të realizuar shfaqje të ndryshme, koncerte, festivale, konferenca, promovime e shumë të tjera në Pallatin e Kulturës në Kamëz. Përgjigjja pozitive ndaj kësaj thirrjeje miqësore ka bërë që të zhvillohen veprimtari të shumta përgjatë gjithë vitit, por veçanërisht në muajin qershor deri më 4 korrik, Pallati i Kulturës ka mirëpritur këto veprimtari:

- 1 qershor 2018 – Dita finale e festivalit “Cicërimat e Kamzës”
- 5 qershor 2018 – Veprimtari ndërgjegjësuere e shkollës “Migjeni”, Durrës
- 6 qershor 2018 – Shfaqje teatrale për fëmijët e Bathores nga trupa e teatrit e drejtuar nga Marjana Kondi “Bon-Boni në mbretërinë e ëmbëlsirave”
- 6 qershor 2018 – Koncerti “Këndoju për ju”, me këngëtarë popullorë
- 8 qershor 2018 – Koncert i shoqërisë artistike “Albanopolis”, organizator Ylli Kalaja
- 18 qershor 2018 – Seminar me gratë e dhunuara
- 23 qershor 2018 – Seminar “Të përqafojmë ndryshimet pozitive në familje”
- 27 qershor 2018 – Shfaqje teatrale për fëmijët e Laknasit nga trupa e teatrit e drejtuar nga Marjana Kondi “Bon-Boni në mbretërinë e ëmbëlsirave”
- 4 korrik 2018 – Koncert i ansamblit “Folk-Alb” nga Avni Ndreu.

### “Të festojmë ndryshimet pozitive në familjen tonë”

Aktiviteti kishte në fokus dëshmi të vërteta të sjella nga prindërit dhe lehtësuesit mbi gjithë përvojën dhe ndikimin në familje gjatë kohës së pjesëmarrjes në trajnim dhe më pas.

Ata u ndalën të flitnin për këto ndjeshmëri.

Secilit prind iu dha një letër në formë zemre, ku shkruan një premtim për familjen e tij që ta mbajë brenda vitit 2018 dhe më pas të gjitha letrat formuan “Zemrën e premtimeve për familjen”.

Pastaj pjesëmarrësit u pyetën se si

do të ishte një komunitet ku mbahen premtimet.

Më pas u kalua në prezantimin e rolit të PMF-së dhe video nga fëmijët e grupeve MF mbi rrathët e besimit, strukturat e MF-së etj. Ky moment synonte informimin e prindërve për rrugën ku duhet të raportohet situata e cenueshmërisë së të drejtave të fëmijëve.

Në fund pati edhe një ceremoni për ndarjen e certifikatave pjesëmarrëse në këtë veprimtari dhe dhurata simbolike.

### Trajnim i organizuar nga Bashkia Kamëz në bashkëpunim me “World Vision” në kuadrin e projektit të mbrojtjes së fëmijëve

